



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 5 Datë 10. 04. 2017

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS
“ PËR PËRDORIM TË BURIMEVE UJORE ”

Në mbështetje të ligjit nr.111/2012 dt.15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të nenit 38 “Qëllimet e përdorimit të burimeve ujore” gërma b, dhe të nenit 41 “Përdorimi me leje i ujit” gërma a dhe ë; të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 , “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin-Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I :

1- Të miratojë kërkesën e subjektit fizik “ **ROGERT LORJA** ” me administrator **z. Rogert LORJA** , me vendodhje në fshatin Ganjolle, Njësia Administrative Gur i Zi , **Bashkia Shkodër , Qarku Shkodër** për përdorim të burimeve ujore të liqenit të Spatharit , pjesë e kaskadës në lumin Drin , për Akuakulturë.

Vepra e marrjes ka këto koordinata: $X_1 - 46\ 53\ 600$; $Y_1 - 43\ 83\ 580$; $Z_1 - + 18\ m$;
Pika e shkarkimit ka këto koordinata : $X_1 - 46\ 53\ 625$; $Y_1 - 43\ 83\ 575$; $Z_1 - + 16\ m$;
Prurja mesatare vjetore e burimit është $0.12\ m^3/sec$.
Prurja mesatare e muajit më të thatë është $0.05\ m^3/sec$.
Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti është $0.02\ m^3/sec$, (20 l/sek).

2-Leja e përdorimit të burimit ujor jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR
Martin PLLUMBI



KRYETAR
Paulin RADOVANI